

KONTRATË PËR BLERJEN E KUOTËS

MIDIS


Tecosystem Engineering S.R.L.


SHITËSI

Four Eagles SH.P.K.

BLERËSI

Data: 30.05.2023

EVIS DALLAKI


CARLO SCIANATICO


KONTRATË PËR BLERJEN E KUOTËS

Sot, më 30 maj 2023, palët e mëposhtme kanë lidhur këtë kontratë për blerjen e kuotës ("**Kontrata**").

"**TECONOSYSTEM ENGINEERING S.r.l.**", një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë, me seli në Bari në Via Devitofrancesco nr. 31/C, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Barit nën R.E.A. nr. BA-324305, Kodi Tatimor nr. 04324920729, nr. TVSH 04790250726, përfaqësuar nga presidenti i bordit të drejtorëve Ing. Canio Scianatico, lindur në Bari më 21.08.1963, ("**Shitësi**"); dhe

"**FOUR EAGLES Sh.p.k.**", një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjit shqiptar, me seli në Tiranë në Rr. "Themistokli Gërmenji" Pall. Ambasadori 1 Kat. I Tiranë, regjistruar në Regjistrin Tregtar Tiranë me numër M22219041R, përfaqësuar nga drejtoresha/administratoresha Evis Duhaxhiu, lindur në Tiranë (ALB) më 27.08.1977 ("**Blerësi**");

Këtu e në vijim Shitësi dhe Blerësi do të referohen bashkërisht si "**Palët**" dhe individualisht si "**Palë**".

Kushtet Paraprake:

- (A) Teconosystem Engineering S.r.l. është ortak i Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor Sh.p.k., një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me seli në Sheshi Skënderbej Tiranë, Shqipëri, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NIPT J618130360 ("**Shoqëria**"). Shitësi zotëron një (1) kuotë e cila përfaqëson 54.89% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- (B) Bashkia e Tiranës është pronare ligjore e një (1) kuote e cila përfaqëson 45.11% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- (C) Palët kanë lidhur një marrëveshje paraprake më datë 25.11.2022 ("**Marrëveshja Paraprake**"), në lidhje me shitblerjen e kuotës, në pronësi të Shitësit, e cili përfaqëson 54,89% të kapitalit themeltar të Shoqërisë ("**Kuota e Shitjes**"). Përfundimi i shitblerjes së Kuotës së Shitjes ("**Transaksioni**") kushtëzohej nga përmbushja nga Shitësi i Kushteve Paraprake të përcaktuara në Nenin 4 të Marrëveshjes Paraprake ("**Kushtet Paraprake**").
- (D) Palët kanë firmosur një shtojcë të Marrëveshjes Paraprake më datë 30.01.2023, ku kanë ranë dakord të zgjasin datën përfundimtare deri më 31.03.2023. Palët bien dakord të zgjasin datën përfundimtare deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Marrëveshja Paraprake dhe shtojca e Marrëveshjes Paraprake i bashkëlidhen kësaj Kontrate si Aneksi 1.
- (E) Pas përmbushjes së Kushteve Paraprake, Palët janë të gatshme të mbyllin Transaksionin dhe të nënshkruajnë këtë akt transferimi të kuotës në përputhje me Nenin 3.1 të Marrëveshjes Paraprake.

PËR SA MË SIPËR, dhe duke marrë parasysh kushtet e mësipërme, Palët bien dakort si më poshtë:

Neni 1

Evis Duhaxhiu
E

CANIO SCIANATICO
2

Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

"Kontratë" do të thotë kjo kontrate e blerjes së kuotës, duke përfshirë deklaratat, shtojcat dhe të gjitha ndryshimet dhe shtojcat e nevojshme të përgatitura në formë të shkruar dhe të nënshkuara nga të dyja Palët.

"Asete" do të thotë asetet e paluajtshme të Shoqërisë, siç dëshmohet nga certifikatat e pronësisë bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje si Aneksi 2 dhe asetet e luajtshme të Shoqërisë siç përfshihen në pasqyrat financiare;

"Shoqëri" ka kuptimin e përcaktuar në Pikën (A).

"Blerësi" ka kuptimin e përcaktuar në hyrje të Kontratës.

"Çmimi i Blerjes" nënkupton çmimin total të blerjes të Kuotës së Shitjes i barabartë me shumën prej 7,100,000.00 Euro (shtatë milionë e njëqind mijë euro), që duhet paguar në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë Kontratë.

"Marrëveshja Paraprake" ka kuptimin e përcaktuar në Pikën (C).

"Shitësi" ka kuptimin e përcaktuar në hyrje të Kontratës.

"Kuota e Shitjes" do të thotë kuotën e Shoqërisë, e cila përfaqëson 54,89% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, në pronësi të Shitësit dhe të gjitha të drejtat që lidhen me të.

"Data e Nënshkrimit" do të thotë dita kalendarike, në të cilën kjo Kontratë nënshkruhet nga të dyja Palët, siç shfaqet në krye ose në fund të kësaj Kontrate.

"Transaksion" ka kuptimin e përcaktuar në Pikën (C).

Neni 2


Transferimi i pronësisë së aksionit/kuotës së shitjes


2.1 Shitësi ia transferon Kuotën e Shitjes Blerësit dhe Blerësi fiton dhe bie dakord të pranojë Kuotën e Shitjes nga Shitësi, duke fituar kështu të drejtën e plotë të pronësisë së Kuotën e Shitjes me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

2.2 Në bazë të Nenit 5.2 të Marrëveshjes Paraprake, Palët bien dakord që e drejta e Blerësit për dividend fillon më 1 janar 2023. Për më tepër, zbatohet Neni 5.2 i Marrëveshjes Paraprake.

2.3 Shitësi merr përsipër të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për transferimin e Kuotës së Shitjes tek Blerësi dhe që transferimi i Kuotës së Shitjes të përfundojë në të gjitha aspektet, në mënyrë që Blerësi të regjistrohet si ortak i Shoqërisë.

Neni 3

ELIS DUKHAMXHIU


CANIO SCIANATICO ³


Çmimi i Blerjes

3.1 Shitësi transferon Kuotën e Shitjes në pronësi të plotë të Blerësit për Çmimin e Blerjes prej 7,100,000.00 Euro (shtatë milionë e njëqind mijë euro).

3.2 Blerësi do t'ia paguajë Shitësit Çmimin e Blerjes me anë të pagesës me transfertë bankare të menjëhershme dhe të pakthyeshme në të njëjtën ditë me të njëjtën datëvalutë (në IBAN IT15H0326804000052950566970 Banca Sella BIC SELBIT2BXXX) në Datën e Nënshkrimit të kësaj Kontrate, dhe në çdo rast jo më vonë se data 30 maj 2023.

3.3 Shitësi pranon që pagesa e Çmimit të Blerjes sipas kësaj Kontrate përbën përbushjen e të gjitha detyrimeve të Blerësit ndaj Shitësit dhe pagesën e vetme për blerjen e Kuotës së Shitjes sipas kësaj Kontrate.

3.4 Çmimi i Blerjes përfshin çdo dhe të gjitha kostot, tarifat dhe taksat që lidhen me shitjen e Kuotës së Shitjes, të cilat do të jenë për llogari të Shitësit, dhe Shitësi nuk do të kërkojë nga Blerësi dhe nuk do të ngrejë asnjë pretendim kundër Blerësit për çdo pagesë ose shumë tjetër shtesë.

3.5 Palët bien dakord që Kontrata e Shitjes së Kuotës do të jetë ligjërisht efektive dhe regjistrimi i shitjes së Kuotës së Shitjes në favor të Blerësit do të finalizohet vetëm pas konfirmimit të marrjes së transfertës prej 7,100,000 Euro (shtatë milionë e njëqind mijë euro) duke hequr komisionet bankare nga banka e Shitësit dhe në çdo rast brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Kontrate.

3.6 Palët parashikojnë që, në rast të mosmarrjes së transfertës bankare për arsye që i atribuohen Blerësit ose bankës së tij, kjo Kontratë nuk do të ketë asnjë efekt juridik dhe Palët do të jenë të lira nga çdo kufizim; për më tepër, në rast se shuma e transferuar nuk bëhet e disponueshme për Shitësin për arsye që i atribuohen ekskluzivisht Shitësit, Blerësi në çdo rast do të ketë mundësinë të regjistrojë blerjen e Kuotës së Shitjes të mbuluar nga kjo Kontratë.


Neni 4

Deklaratat dhe Garancitë e Shitësit

4.1 Shitësi deklaron dhe garanton që Kushtet Paraprake të përcaktuara në Nenin 4 të Marrëveshjes Paraprake janë të përbushura në Datën e Nënshkrimit, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) Shitësi i ka dorëzuar Blerësit siç duhet pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin financiar 2022, bashkëlidhur kësaj Kontrate si *Aneksi 3*;
- (b) Shitësi ka zgjatur për një kohë të pacaktuar kohëzgjatjen e Shoqërisë me vendim të ortakëve të Shoqërisë, datë 05.12.2022, bashkëlidhur kësaj Kontrate si *Aneksi 4*;
- (c) Shoqëria ka ndryshuar Statutin me vendim të ortakëve të Shoqërisë, datë 05.12.2022. Statuti i Shoqërisë është bashkëlidhur kësaj Kontrate si *Aneksi 5*;
- (d) Secili nga administratorët e Shoqërisë kanë dorëzuar dorëheqjet e tyre, bashkëlidhur kësaj Kontratë si *Aneksi 6*;

Evis DUKHAKITIU
f

CANIO SCIANATICO  4

(e) Shitësi ka përfunduar marrëveshjen e konsulencës datë 10.01.2011 të lidhur nga dhe ndërmjet Shoqërisë dhe Shitësit me ane të një marrëveshje zgjidhje të marrëveshjes së konsulencës, datë 30.05.2023, bashkëlidhur kësaj Kontrate si *Aneksi 7*;

(f) Janë lëshuar certifikatat e fundit (jo më të vjetra se një muaj nga Data e Nënshkrimit të Kontratës) të pronësisë dhe kartelat përkatëse të Aseteve të paluajtshme të Shoqërisë, të renditura në Shtojcën 6 të Marrëveshjes Paraprake, dhe ato dëshmojnë se titujt e pronësisë së Aseteve të paluajtshme të Shoqërisë janë të vlefshme dhe në gjendje të mirë, dhe ato nuk i nënshtrohen asnjë limitimi, kufizimi, hipoteke, barre, tarife ose çfarëdo të drejte për përfitimin e palëve të treta.

4.2 Shitësi deklaron dhe garanton se (i) ka marrë siç duhet pëlqimin e Bashkisë së Tiranës për transferimin e Kuotës së shitjes tek Blerësi; (ii) i ka komunikuar Transaksionin ortakut minoritar (Bashkia e Tiranës) dhe (iii) se Bashkia e Tiranës ka autorizuar zyrtarisht shitjen e Kuotës së Shitjes në favor të Blerësit dhe Shitësi ka hequr dorë siç duhet nga e drejta e parablerjes mbi Kuotën e Shitjes, në përputhje me Nenin 5.11 të Marrëveshjes Paraprake. Vendimi i Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 43, datë 19.04.2023, mbi pëlqimin për Transaksionin dhe heqjen e së drejtës së parablerjes i bashkëlidhet kësaj Kontrate si *Aneksi 8*.

4.3 Nënshkrimi i kësaj Kontrate dhe plotësimi nga Shitësi i të gjitha kushteve dhe detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë nuk është kundër dhe nuk përbën shkelje të ndonjë kontrate, marrëveshjeje, urdhri, vendimi gjyqësor ose ndonjë vendimi tjetër nga një autoritet shtetëror, i huaj ose vendas, që kanë juridiksion mbi Shitësin ose Shoqërinë, ose për çdo angazhim ose marrëveshje tjetër në të cilën Shitësi dhe/ose Shoqëria janë palë.

4.4 Nënshkrimi i kësaj Kontrate është miratuar shprehimisht nga vendimi i ortakëve të Shitësit më 07.11.2022, bashkëlidhur këtu kësaj Kontrate, si *Aneksi 9*.

4.5 Pasqyrat financiare për vitin e fundit financiar (viti 2022) miratohen nga mbledhja e përgjithshme e ortakëve të Shoqërisë dhe ato përgatiten në përputhje të plotë me parimet e pasqyrave financiare dhe parimet e kontabilitetit; fitimet e viteve të mëparshme financiare dhe deri më 31.12.2022, duke marrë parasysh shënimet e rregullimit dhe të gjitha dispozitat e nevojshme, do të jenë përgjegjësi e vetme e Shitësit i cili do të vendosë në mënyrë të pavarur se si do t'i shpërndajë ato; ndërsa rezultatet e funksionimit të përlllogaritura pas datës së Marrëveshjes Paraprake ose nga data 01.01.2023 do të jenë në favor të plotë të Blerësit.

4.6 Gjatë periudhës ndërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes Paraprake dhe nënshkrimit të kësaj Kontrate: (i) drejtorët/administratorët e Shoqërisë dhe, në masën e kompetencës së tyre, drejtuesit, zyrtarët dhe punonjësit e Shoqërisë kanë vepruar në pajtueshmërinë e plotë me çdo dispozitë të ligjeve në fuqi dhe kanë menaxhuar Shoqërinë në rrjedhën e zakonshme të biznesit; (ii) biznesi i Shoqërisë drejtohet dhe menaxhohet siç duhet, në përputhje me rregulloret dhe detyrimet e ndërmarra në fuqi, brenda kufijve të administrimit të zakonshëm dhe në vazhdimësi me drejtimin e mëparshëm pa ndryshuar metodat e kontabilitetit, parimet përkatëse ose praktikatat administrative dhe/ose kontabiliteti përkatëse; (iii) Shoqëria nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje të re qiraje, dhe nuk ka ndryshuar, as zgjatur afatin e asnjë prej marrëveshjeve ekzistuese të qirasë me qiramarrësit e Aseteve të paluajtshme të Shoqërisë pa miratimin paraprak me shkrim të Blerësit .

4.7 Shitësi deklaron, përfaqëson dhe garanton që kapitali themeltar i autorizuar dhe i emetuar i Shoqërisë është emetuar dhe paguar plotësisht. Kuota e Shitjes e Shoqërisë ka mbetur në dispozicion të lirë të saj deri më sot dhe nuk ndikohet nga barra, pengu ose barra të tjera, siç dëshmohet nga Ekstrakti i Shoqërisë i lëshuar nga Regjistri Tregtar dhe certifikata e regjistrimit të Barrave Siguruese, bashkëlidhur këtu si *Aneksi 10*.

Evis DUKANXHIU
A

CARMO SCIANATICO
5

4.8 Dispozitat e Marrëveshjes Paraprake, duke përfshirë, por pa u kufizuar në dispozitat (Neni 5 i Marrëveshjes Paraprake) që rregullojnë Garancitë e Shitësit në lidhje me Kuotën e Shitjes dhe Shoqërinë, janë të vërteta dhe të sakta në Datën e Nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe do të konsiderohen se janë përfshirë me referencë këtu sikur të parashtroheshin fjalë për fjalë më poshtë, *mutatis mutandis*, dhe do të jenë të detyrueshme në përputhje me kushtet e tyre dhe kushtet e kësaj Kontrate; Neni 8.5 i kësaj Kontrate do të zbatohet për Garancitë e Shitësit.

Neni 5

Deklaratat dhe Garancitë e Blerësit

5.1 Zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi është i vlefshëm dhe në asnjë rast nuk do të rezultojë në ndonjë shkelje, ose pavlefshmëri sipas ndonjë marrëveshjeje, kontrate ose gjykimi në të cilin Blerësi është palë ose me të cilën ka lidhje dhe e cila shkelje do të ndikonte negativisht në aftësinë e Blerësit për të përmbushur kushtet e kësaj Kontrate.

5.2 Nënshkrimet e kësaj Kontrate në emër të Blerësit janë nënshkrime të autorizuara siç duhet për të ekzekutuar këtë Marrëveshje.

Neni 6

Dëmshpërblimi

6.1 Shitësi do ta mbajë Blerësin të padëmtuar dhe do ta dëmshpërblejë plotësisht atë në rast dëmi (duke përfshirë, por pa kufizuar dëmin, mungesën e fitimit, çdo kosto ose kosto duke përfshirë tarifën e avokatëve) për shkak të ndonjë shkeljeje të deklaratave dhe garancive të parashikuara në paragrafët e mësipërm, si dhe çdo neni tjetër të kësaj Kontrate, në lidhje me dhe veçanërisht pa u kufizuar mbi Asetet dhe/ose Kuotën e Shitjes.

6.2 Në veçanti, Shitësi do të jetë i detyruar të paguajë në favor të Blerësit çdo detyrim, të çfarëdo natyre, që lind pas Datës së Nënshkrimit të kësaj Kontrate, duke përfshirë çdo detyrim tatimor, i cili është pasojë e aktivitetit të Shoqërisë para Datës së Nënshkrimit dhe / ose pasojë e menaxhimit të mëparshëm të Shoqërisë; në përgjithësi, çdo detyrim (përfshirë detyrimet tatimore), taksë, tarifë, penalitet, dëmshpërblim që rrjedh nga pretendimet e palëve të treta (përfshirë dhe autoritetet shtetërore dhe/ose tatimore), bazuar në akte ose fakte që i atribuohen menaxhimit përpara Datës së Nënshkrimit, edhe nëse manifestohet në një kohë pas kësaj date, dhe / ose në shkelje të garancive të Shitësit në këtë Kontratë dhe/ose në Marrëveshjen Paraprake dhe / ose që nuk janë pasqyruar apo theksuar siç duhet në pasqyrat financiare për vitin e fundit financiar 2022, duhet t'i paguhet / dëmshpërblehen nga Shitësi ose Blerësit, ose Shoqërisë, sipas rastit.

6.3 Nëse ndonjë pretendim ose detyrim (duke përfshirë pa kufizim taksat, gjobat ose pretendimet e palëve të treta) do të vendoset kundër Shoqërisë ose Blerësit pas Datës së Nënshkrimit të Kontratës, në lidhje me Shitësin ose Shoqërinë ose Asetet e Shoqërisë për periudhën e mëparshme deri në Datën e Nënshkrimit të Kontratës ose në lidhje me transferimin e Kuotës së Shitjes dhe/ose Aseteve të Shoqërisë në Datën e Nënshkrimit të Kontratës, Shitësi do të jetë i vetmi përgjegjës për këto pretendime dhe/ose detyrime dhe në një mënyrë të përbashkët dhe individuale do të zhdëmtojë Shoqërinë dhe/ose Blerësin kundër pretendimeve dhe detyrimeve të tilla dhe çdo kosto që lidhet me to.

Evis DUKANXHIU
f

CANIO SCIANATICO
f

6.4 Shitësi është përgjegjës për të gjitha pagesat (duke përfshire por pa u limituar në: paga, vjetërsi në punë, dëmshpërblim, pushime të papaguara, etj.) përkundrejt administratorëve të Shoqërisë deri në Datën e Nënshkrimit, si pasojë e marrëdhënies së administratorëve me Shoqërinë (duke përfshire edhe kontratat e punës, edhe marrëdhënien si administrator) dhe / ose si pasojë e dorëheqjes / shkarkimit të tyre dhe/ose përfundimit të kontratave të punës. Nëse administratorët ngrenë padi kundër Shoqërisë, Shitësi do të dëmshpërblejë të gjitha humbjet që do të ketë Shoqëria nga këto padi duke përfshirë edhe honoraret e avokatëve dhe shpenzimet e tjera gjyqësore ose jashtë gjyqësore.

6.5 Shitësi është përgjegjës për çdo tatim, taksë, penalitet që mund t'i lindë Shoqërisë si pasojë e Transaksionit dhe / ose në lidhje me shitjen e Kuotës së Shitjes dhe Çmimit e Blerjes. Në rast se Shoqëria do të ketë humbje si pasojë e detyrimeve të tilla tatimore, Shitësi detyrohet të dëmshpërblejë Shoqërinë duke i paguar menjëherë shumën e plotë të detyrimit, penaliteteve, gjobave dhe / ose shpenzimeve të tjera (gjyqësore ose jashtëgjyqësore).

Neni 7


Regjistrim dhe Bashkëpunim


7.1 Palët kanë rënë dakord që pronësia e kuotës do të konsiderohet se i transferohet Blerësit në përputhje me dispozitat e Nenit 3.5 më sipër. Palët kanë rënë dakord që kjo Kontratë dhe Transaksioni i parashikuar këtu të dorëzohen për regjistrim në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe struktura e re e ortakëve do të regjistrohet në librin e ortakëve të Shoqërisë menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.

7.2 Shitësi do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të bashkëpunuar në mirëbesim me Blerësin, në lidhje me transferimin e plotë të Kuotës së Shitjes nga Shitësi tek Blerësi. Mosrespektimi i këtij Neni do të konsiderohet shkelje e rëndë e kësaj Kontrate.

7.3 Në Datën e Nënshkrimit, Shitësi do t'i sigurojë Blerësit, përpara pagesës së Çmimit të Blerjes, Aneksat e renditura si më poshtë:

- Aneksi 1: Marrëveshja Paraprake dhe shtojca e Marrëveshjes Paraprake;
- Aneksi 2: Kartelat e rifreskuara të pasurive të paluajtshmeve të Shoqërisë, që evidentojnë tituj të pastër dhe të padiskutueshëm mbi këto Asete, pa hipotekë, peng, barrë dhe çdo kufizim tjetër, apo të drejtë të palëve të treta;
- Aneksi 3: Bilanci i Shoqërisë i datës 31.12.2022;
- Aneksi 4: Vendim i ortakëve të Shoqërisë, datë 05.12.2022, për miratimin e zgjatjes së afatit të Shoqërisë;
- Aneksi 5: Statuti i Shoqërisë;
- Aneksi 6: Letrat e dorëheqjes së administratorëve të Shoqërisë;
- Aneksi 7: Marrëveshja e zgjidhjes të marrëveshjes së konsulencës, datë 30.05.2023;
- Aneksi 8: Vendimi i Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 43, datë 19.04.2023, për pëlqimin për Transaksionin dhe heqjen dorë nga e drejta e parablerjes;
- Aneksi 9: Vendimi i Asamblesë së Ortakëve së Shitësit që miraton shitjen e Kuotës së Shitjes dhe nënshkrimin e kësaj Kontrate;
- Aneksi 10: Certifikata e Kuotave, Ekstrakt i Shoqërisë i lëshuar nga Regjistri Tregtar, dëshmi nga regjistri i Barrave Siguruese që Kuota e Shitjes nuk është lënë peng;

Elvis DUKHAKU


7
CANIO SCIANATICO


Neni 8**Të ndryshme**

8.1 Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjen midis Palëve dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme verbale ose me shkrim ndërmjet Palëve. Kjo Kontratë hyn në fuqi në Datën e Nënshkrimit.

8.2 Pavarësisht nga sa më sipër, të gjitha termat dhe kushtet e Marrëveshjes Paraprake do të ruajnë vlefshmërinë dhe efektivitetin e tyre edhe pas përfundimit të nënshkrimit të kësaj Kontrate. Palët bien dakord që në rast mospërputhjeje, dispozitat e kësaj Kontrate mbizotërojnë, si të vetmet që rregullojnë dhe qeverisin marrëdhëniet ndërmjet Palëve.

8.3 Në rast se ndonjë dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate është e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme në një juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e atyre dispozitave ose detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të ndikohen nga ky fakt. Palët do të përpiqen të zëvendësojnë një dispozitë të pazbatueshme ose të pavlefshme, në masën më të madhe të mundshme, për të arritur qëllimin e kësaj dispozite.

8.4 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate do të jetë e vlefshme vetëm nëse kryhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës Palë.

8.5 Kjo Kontratë rregullohet nga ligji i Republikës së Shqipërisë në fuqi në Datën e Nënshkrimit. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim ose pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë ose ndonjë Dokument lidhur me Transaksionin, duke përfshirë çdo mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë e saj ose përfundimin e saj ose shkëlqes të kësaj Kontrate ose ndonjë dokument lidhur me Transaksionin, si dhe çdo detyrimi jo-kontraktor që rrjedh prej ose në lidhje me të, zgjidhet përfundimisht nga gjykatat kompetente shqiptare.

8.6 Kjo Kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe dhe italiane në 4 (katër) kopje identike të versionit në çdo gjuhë, nga të cilat një për secilën palë dhe një kopje për kërkesat për regjistrimin e ndryshimit të ortakut në Regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit Shqiptar. Në rast mospërputhjeje ndërmjet versioneve në gjuhën shqipe dhe italiane, do të mbizotërojë versioni në gjuhën italiane.


8.7 Të gjitha komunikimet dhe njoftimet ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Kontratë do të bëhen me shkrim dhe do të dërgohen në adresat e dhëna nga Palët për qëllime komunikimi, si më poshtë:

Shitësi:

TecnoSystem S.r.l.
Bari Italy
Via Devitofrancesco n 31/C
Canio Scianatico

Blerësi:

Evis DUKHANI


CANIO SCIANATICO
⁸

Four Eagles Sh.p.k.
Tiranë Shqipëri
Rr Themistokli Gërmenji
Pall Ambasador 1
Kat 1
Evis Duhaxhiu

Evis DUHANXHIU
E

CANIO SCIANATICO ⁹ *Plan*

SHITËSI

NËNSHKRUAR

Nga: Tecnosystem Engineering S.r.l.
Emri: Canio Scianatico
Titulli: Drejtor Ekzekutiv

TECNO SYSTEM
ENGINEERING S.R.L.

Canio Scianatico
CANIO SCIANATICO

BLERËSI

NËNSHKRUAR

Nga: Four Eagles Sh.p.k.
Emri: Evis Duhaxhiu
Titulli: Administratore

Evis Duhaxhiu

